



REPUBLIKA E MAQEDONISË SË VERIUT
AGJENCIA PËR SHËRBIME MEDIATIKE
AUDIO DHE AUDIOVIZUELE
PA1 nr .08-331
17.10.2023
Shkup

Këshilli i Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele në bazë të nenit 18, paragrafi (1), nënparagji 22 dhe neni 20, paragrafi (1), nënparagrafi 10¹ të Ligjit për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele ("Gazeta Zyrtare e RM-së" nr.184/13, 13/14, 44/14, 101/14, 132/14, 142/16, 132/17, 168/18, 248/18 dhe 27/19 dhe "Gazeta Zyrtare e RMV-së" nr 42/20, 77/21 dhe 154/23), neni 10, paragrafi (5), neni 15, paragrafi (1), nënparagrafi 19 dhe neni 39, paragrafi (1), nënparagrafi 10 të Rregullores së punës së Agjencisë (Tekst i pastruar) ark.nr.01-3732/1 datë 29.07.2019 dhe neni 9 të Ligjit për Procedurë të Përgjithshme Administrative ("Gazeta Zyrtare e RM-së" nr.124/15), dhe në lidhje me nenin 94, paragrafi (2) nga Ligji i njëjtë, sipas Konkluzionit ark.nr.02-3637/3 datë 09.10.2023 dhe Njoftimit ark.nr.10-3676/2 datë 13.10. 2023, Këshilli i Agjencisë, në seancën e 33-të mbajtur më 16.09.2023, në pajtim me Propozimin PA1 nr.08-331, datë 13.10. 2023 dhe Konkluzionin ark.nr.02-3741/2 datë 17.10. 2023, miratoi:

Aktvendim
për vazhdimin e afatit për vendimarrje
pas procedurës së inicuar për heqjen e lejes

1. VAZHDOHET afati (19.10.2023) për miratimin e vendimit nga Këshilli i Agjencisë sipas Propozimit për iniciimin e procedurës për heqjen e lejes të Shoqërisë Tregtare Radiodifuzive Radio KANAL 77 SHPKNJP Shtip PA1. nr.08-331 datë 05.10.2023, për jo më gjatë se 30 (tridhjetë) ditë, për shkak të lëndës së ndërlikuar, gjegjësisht specifikës së mbikëqyrjes së jashtëzakonshme programore e cila duhet të kryhet për të verifikuar nëse transmetuesi i ka mënjanuar pengesat ligjore për kryerje të veprimtarisë.

2. Vendimi është publikuar në ueb faqen e Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele.

3. Ky vendim është përfundimtar dhe hyn në fuqi menjëherë.

A r s y e t i m

Këshilli i Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele (Agjencia) në seancën e 32-të të mbajtur më 09.10.2023, sipas Propozimit PA1 nr.08-331, datë 05.10.2023, të dr.Zoran Trajčevski, Drejtor i Agjencisë, për shkelje të nenit 68, në lidhje me nenin 3, paragrafi (1), pika 12 të Ligjit për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele (LSHMAAV), miratoi Konkluzionin ark.nr.02-3637/3 datë 09.10.2023 sipas të cilit është inicuar procedurë për heqjen e lejes për transmetim në radio të Shoqërisë Tregtare Radiodifuzive (SHTR) Radio KANAL 77 SHPKNJP Shtip, PA1 nr.08-64 datë 05.01.2015, e vazhduar me Vendimin PA1 nr.08-258 datë 15.08.2023.

Agjencia drejtuar SHTR Radio KANAL 77 SHPKNJP Shtip, dërgoi Njoftimin PA1 nr. 08-331 datë 09.10.2023 për iniciimin e procedurës për heqjen e lejes për transmetim në radio (për shkak të konstatimit të pengesave ligjore për kryerjen e veprimtarisë - sigurimin e transmetimit të një shërbimi të vetëm programor të transmetuar në tërësi të programeve dhe elementeve të tjera të një shërbimi të vetëm audio mediatik në zona të cilës i është dhënë leje – i gjithë territori i Republikës së Maqedonisë së Veriut).

¹Nënpargrafët 8 dhe 9 fshihen, shih: neni 8 të Ligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 248/18).

Transmetuesi është udhëzuar që menjëherë të harmonizojë punën e tij me LSHMAAV, gjegjësisht të mënjanon pengesat ligjore për kryerjen e veprimtarisë dhe është njoftuar se në të kundërtën Këshilli i Agjencisë në afat prej 15 ditësh nga pranimi i Propozimit për ngritjen e procedurës për heqjen e lejes (PA1 nr.08-331 datë 05.10.2023), do të miraton Vendim për heqjen e lejes për transmetim në radio të SHTR Radio KANAL 77 SHPKNJP Shtip, PA11 nr 08-64, datë 05.01.2015, e vazhduar me Vendimin PA1. nr.08-258 datë 15.08.2023.

Në pajtim me nenin 83, paragrafi (3) të LSHMAAV, Këshilli është i obliguar që në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimi të propozimit nga drejtori për iniciimin e procedurës për heqjen e lejes, të miraton vendim me shumicë votash nga numri i përgjithshëm i anëtarë të Këshillit, pra jo më vonë se data 19.10.2023.

Më datë 13.10.2023 Sektori për Çështjet Programore i ka dorëzuar Drejtorit të Agjencisë Njoftimin ark.nr.10-3676/2 datë 13.10.2023 në të cilin thuhej se është e nevojshme të kryhet mbikëqyrje e re e jashtëzakonshme programore për të kontrolluar nëse transmetuesi i ka mënjeluar pengesat ligjore për kryerjen e veprimtarisë dhe atë nëpërmjet disa frekuencave të shfrytëzuara nga transmetuesi për të mbuluar të gjithë territorin e Shtetit, gjë që nënkupton organizim të regjistrimit, të dëgjimit, analizimit dhe në mënyrë të duhur të regjistrohet çdo sekondë e programit të transmetuar. Vetë analiza krahasuese pas marrjes së regjistrimeve nga programi, për shkak të ndërlikimit, do të zgjasë shumë më gjatë se mbikëqyrjet e tjera programore të zbatuara nga Agjencia, kështu që sektori kompetent raportoi se nuk ka kushte që kjo mbikëqyrje të kryhet para afatit për të cilin Këshilli i Agjencisë duhet të marrë vendim pas procedurës së iniciuar.

Sipas njoftimit të përmendur, Drejtori i Agjencisë i dorëzoi Këshillit të Agjencisë Propozimin PA1 nr. 08-331, datë 13.10.2023, për miratim të aktvendimit për vazhdimin e afatit për vendimmarrje pas procedurës së iniciuar për heqjen e lejes.

Në pajtim me nenin 9 të Ligjit për Procedurë të Përgjithshme Administrative (LPPA), kur organet publike vendosin për çështje administrative, ata janë të orientuar drejt realizimit të të drejtave dhe interesave të palëve.

Neni 94, paragrafi (2) i LPPA përcakton se vazhdimi i afatit në procedurën e shkallës së parë lejohet për periudhën që është e nevojshme për përfundimin e procedurës, në varësi nga ndërlikimi i lëndës, por nuk mund të jetë më gjatë se 30 ditë.

Duke marrë parasysh sa më sipër, për shkak të ndërlikimit të lëndës, gjegjësisht specifikave të mbikëqyrjes së jashtëzakonshme programore që duhet të kryhet për të kontrolluar nëse transmetuesi i ka mënjeluar pengesat ligjore për kryerjen e veprimtarisë, dhe në pajtim me parimin e orientimit në shërbim të organeve publike, në bazë të nenit 18, paragrafi (1), nënparagrafi 22 dhe neni 20, paragrafi (1), nënparagrafi 10² të Ligjit për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale, neni 10, paragrafi (5), neni 15, paragrafi (1), nënparagrafi 19 dhe neni 39, paragrafi (1), nënparagrafi 10 të Rregullores së punës së Agjencisë (Teksi i pastruar) dhe neni 9 të Ligjit për Procedurë të Përgjithshme Administrative, si dhe në lidhje me nenin 94, paragrafi (2) nga Ligji i njëjtë, sipas Konkluzionit ark.nr.02-3637/3, datë 09.10.2023. dhe Njoftimit ark.nr.10-3676/2 datë 13.10.2023, Këshilli i Agjencisë, në seancën e 33-të mbajtur më 16.10.2023, sipas Propozimit PA1 nr.08-331 datë 13.10.2023 dhe Konkluzionit ark.nr.02-3741/2 datë 17.10. 2023, miratoi aktvendim si në dispozitiv.

**Agjenci për Shërbime Mediatike
Audio dhe Audiovizuale
Kryetari i Këshillit,
Lazo PETRUSHEVSKI, d.v.**

Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi transmetuesi ka të drejtë padie për ngritje të kontestit administrativ para gjykatës kompetente. Padia për ngritjen e kontestit administrativ paraqitet në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimi të aktvendimit.

²Nënpagrafët 8 dhe 9 fshihen, shih: nenin 8 të Ligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale (" Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë " nr.248/18).